



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Nr. Cila org. Org. Jedinica Org. Unit	01
Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages	01
Titull Prof. Broj Prof. Prof. No.	9711
Data Datum Date	20.12.23
PRISHTINË / A	
No.2	

Ministria e Mjedisit ,Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment , Spatial Planning and Infrastructure

Zv.Ministri i Ministrisë së Mjedisit Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), bazuar ne dispozitat e nenit 7 (paragrafi 2) të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin ndër urban të udhëtarëve me autobus dhe nenit 8 (paragrafi 3) të Rregullores nr. 14/2023 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe 21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus dhe rekomandimit të komisionit profesional, nxjerr këtë:

VENDIM

I.APROVOHET ankesa nr.8879 të datës 17.11.2023 parashtruar nga operatori i transportit rrugor të udhëtarëve me autobus NTP“DILI COMMERCE” me seli në Shtime, kundër vendimit nr.8423 të datës 03.11.2023 mbi shpalljen e nisjeve të lira ndër-urbane nëpër regjione respektivisht nisja ne relacionin: Ferizaj - Shtime (10:40-11:40).

II.ANULOHET nisja e shpallur ne relacionin Ferizaj - Shtime (10:40-11:40) e shpallur sipas vendimit nr.8423 të datës 03.11.2023 mbi shpalljen e nisjeve të lira ndër-urbane.

ARSYETIM

Komisioni i emëruar nga Ministri sipas vendimit nr.8973 datë 22.11.2023 pas shqyrtimit të ankeses, verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi repektivisht nenet 5 (paragrafi 4) dhe 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus, poashtu duke pasë parasyshë faktin se sipas rrjetit aktual te nisjeve nderurbane koha minimale e operimit ndermejt nisjeve ekzistuese te vertetuara nga MMPHI-ja ne kete relacion eshte 15 minuta ndermjet nisjeve respektive dhe kjo paraqet pengese ne nisjet tjera te

Faqe 1 nga 2

Objekti “Ish- Gërmia”, Rr . Nëna Terezë - 10.000 Prishtinë, Kosovë

<http://ëëë.mit-ks.net>

vertetuara, gjithsesi duke nisur nga fakti se kjo trase eshte e mbuluar me nise te mjaftueshme te vertetuara nga MMPHI.

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë vendimi është marrë si në dispozitiv.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtrojë padi në Gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Parashtruesit të ankesës;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Arkivit të MI -së

